

FJALA E DEPUTETES JORIDA TABAKU

E ENJTE 16 QERSHOR 2022

Të nderuar qytetarë,

E dëgjova zotin Braçe, në fakt, me shumë interes, siç dëgjoj pak kolegë këtu në parlament. Arrita të konkludoj në 4 paradokset e qeverive "Rama": "Punë ka, nuk ka profesionistë. Profesionistë nuk ka, por Shqipëria ka rilindur. Rilindja erdhi, shqiptarët po ikin. Shqiptarët ikin, por Shqipëria ka një rritje të jashtëzakonshme, galopante." Se çfarë duhet të besoj nga këto, në fakt, unë nuk e di! Situata ekonomike, sigurisht, edhe ajo politike që po kalon gjithë globi, në mënyrë të veçantë Shqipëria, nuk është më e mira e mundshme.

Duhet ta pranojmë që lufta në Ukrainë ka pasur efekte në ekonominë shqiptare, askush nuk e ka mohuar. Por përpara se të bëjmë liderët në Kiev dhe në çdo qytet tjetër të botës, unë besoj që lideri duhet bërë këtu dhe vendimet e rëndësishme duhen marrë këtu. Filozofia e ndjekur nga qeveria shqiptare ka qenë aq problematike, sa, ndonëse jemi vendi me borxhin më të lartë publik në rajon, ne kemi pasur gjithmonë ndihmën më të ulët. Nuk do të ndalem në shifra, sepse i thashë javën e kaluar. Kjo situatë ka prodhuar më pak të ardhura për konsumatorët dhe për sipërmarrjet. Nga ana tjetër, ka pasur një presion shumë të rritur të inflacionit, i cili ka filluar të ndihet që verën e vitit të shkuar.

Çfarë bën qeveria shqiptare në këto kushte? Merr eurobond. Inflacioni dhe goditjet e tij, sigurisht që u bënë më të forta pas luftës në Ukrainë, por, ndërkohë, efektet që po ndihen në familjet shqiptare janë gjithmonë e më të larta. Sipas përlllogaritjeve, rezulton se norma e inflacionit vetëm te familjet e varfra është rritur me 1%, në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ndikuar në zvogëlimin e atyre pak të ardhurave, 5 dollarë në ditë, që kanë pasur familjet shqiptare. Përveç kësaj, situata me borxhin publik, në gjykimin tim, është jashtëzakonisht problematike. Me gjithë paralajmërimet e ndryshme të FMN-së në lidhje me shpenzimet e qeverisë dhe borxhin e marr prej saj, unë dua të veçoj këshillën e vazhdueshme për heqjen

dorën nga projektet me risk të lartë, si PPP-të, nga borxhi i fshehur, nga detyrimet e prapambetura dhe nga kostot e arbitrazhit.

Qeveria ka vazhduar ta trajtojë këtë temë jo me konservatorizmin e duhur financiar. Fatkeqësisht, edhe pse e di që Guvernatori m'i merr të gjitha kritikrat pozitivisht, edhe për të përmirësuar punën, Banka e Shqipërisë nuk ka arritur dot të jetë një oponencë reale për qeverinë në këtë drejtim. E njëjta situatë është shfaqur të paktën 3 vjetët e fundit, por kjo ka ndodhur në 8 vjet, në mënyrë të pashmangshme, sa herë që qeveria shqiptare ka marr borxh. Ndërkohë që, përveç presioneve inflacioniste, ne vazhdojmë të shohim edhe një problem tjetër që ka nisur vite më parë. Në Shqipërinë e 3 milionë banorëve, ku konkurrenca është gjithmonë dhe më e vështirë, situata në tregun bankar, sidomos në bankat e nivelit të dytë, është jashtëzakonisht problematike.

Ka shumë banka të nivelit të dytë, që qendrën e tyre operative nuk e kanë më në vendet e Bashkimit Europian, por pronësia e tyre po ndryshon. Do të kisha dashur që Banka e Shqipërisë të kishte një reflektim për këtë, të jepte një mendim për këtë, që të shikojmë se çfarë mund të bëjmë, që të ndryshojmë gjërat. Ndërkohë që flasim, në një situatë të pazakontë ekonomike, ku shifrat për herë të parë flasin (e dëgjova edhe nga zëvendëskryeministri) për stagflacion, Banka e Shqipërisë ka nisur një problem, digjitalizimin. Pra, ka nisur një projekt digjitalizimi. Shqetësimi im, sa herë që e kam dëgjuar, ka qenë aksesit në financa i shtresave të varfra.

Si do të merren pensionet? Si do të merret ndihma ekonomike? Çfarë do të bëhet për këto shtresa? Sigurisht, duke pasur prioritet buxhetin dhe financat publike, në këtë moment qeveria duhet të kishte këto shtresa në fokus dhe jo projektet, të cilat mua më duken totalisht jashtë realitetit dhe jashtë fokusit në këtë moment për ekonominë shqiptarë. Situata ekonomike në fushën e bujqësisë është problematike, pasi bujqësia rezulton si një nga sektorët me potencialin më të lartë, por me rritjen më të ulët, herë-herë edhe negative. Ndërkohë që nuk ka asnjë të dhënë për qasjen e Bankës së Shqipërisë ndaj këtij fenomeni. E dëgjova me shumë kureshtje Guvernatorin kur tha: "Kemi një rritje me bazë të gjerë". Jo, nuk kemi një rritje me bazë të gjerë. Është rritur sektori i ndërtimit vitin e kaluar, është rritur nga pagesat e rindërtimit në periudhë zgjedhësh.

Nuk është rritje me bazë të gjerë, se nuk janë të gjithë sektorët që po prodhojnë, nuk po ecin të gjithë sektorët, ashtu siç duhet të kishin ecur në një vit rimëkëmbje mbas pandemisë dhe mbas tërmetit. Pikëpyetje ngrihen njëkohësisht me zbatimin e projekteve të prokurimeve publike, PPP-ve, që unë besoj se kanë lidhje të drejtpërdrejtë me menaxhimin e buxhetit dhe me shëndetin e financave publike. Nga ana e Bankës së Shqipërisë, sigurisht, unë kisha pritur më shumë presion mbi qeverinë, për të mos vazhduar me projektet joprioritare, sepse sot 50% e produktit të brendshëm bruto është e angazhuar me fonde, të cilat lidhen me koncesione dhe me PPP-të. Unë besoj se nevojitet një mbikëqyrje më e lartë edhe për tregun e kredive.

Tregu i kredive, sidomos në rastin e kredive të paluajtshme, zë pothuajse 64% të kredisë për individët dhe kredia e ndërtimit zë 13% të totalit të kredisë për ndërmarrjet. Ky është një problem real dhe unë kisha dashur të shikoja Bankën e Shqipërisë se çfarë masash do të marrë për pastrimin e parave. Çfarë po ndodh me mekanizmat e ngritur për pastrimin e parave? Si ka mundësi që Shqipëria përsëri ishte në Listën Gri të MONEYVAL-it për pastrimin e parave, ndërkohë që po diskutohet dhe ligji i amnistisë fiskale? Gjatë ditëve të kaluara kam diskutuar me kolegë, me bashkëpunëtorë dhe njëkohësisht me aktorë të shqetësuar të komitetit ndërkombëtar për ligjin e amnistisë fiskale, i cili i hap rrugë një kapitali që në Shqipëri, të paktën, në Shqipërinë ku ne diskutojmë për proceset integruese, nuk duhet të ishte në diskutim.

Ligji i amnistisë fiskale, ashtu siç unë e kam lexuar, ashtu siç është shkruar, sigurisht që vendos një rrezik të jashtëzakonshëm për Shqipërinë në drejtim të pastrimit të parave, por ajo që është më e rëndësishmja, në drejtim të një prej kritereve të procesit të integritetit. Njëkohësisht, nga Banka e Shqipërisë do të kisha dashur të diskutonim edhe për faktin që sot borxhi publik ka shkuar pothuajse 3-shifror. Unë e di që qeveria do të ngrihet këtu dhe do të kthejë përgjigje: “Borxhi është në nivelin 70%, e morëm kaq e çuam kaq, 235 detyrime të prapambetura...”. Kjo është retorikë që e kemi dëgjuar shpesh.

Por në kushtet ku jemi, kur faturat e arbitrazhit, sipas informacionit zyrtar që kam marrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, shkojnë në 385 milionë euro, kur detyrimet e të gjitha kontratave koncensionare kanë shkuar në pothuajse në 12% të produktit të brendshëm bruto, kur kemi

detyrime të prapambetura të kontratave në punë (dhe pak ditë më parë u miratua një fond shtesë për rindërtimin, i cili thjesht legalizoi shpenzimet e kaluara për rindërtimin, të cilat ishin jashtë llogarive buxhetore), unë besoj se ky duhej të ishte një shqetësim i jashtëzakonshëm për financat publike dhe një kampion alarmi për qeverinë, të cilin duhet ta diskutojmë që të gjithë.

Në qoftë se themi që kriza është te dera, dhe kriza është te dera, e keqja akoma s'ka ardhur, si nga pikëpamja e furnizimit, ashtu edhe nga pikëpamja e disa treguesve që javën e kaluar unë i ndava këtu me ju, për indeksin e çmimit të importit, por edhe për indeksin e çmimit të prodhimit (që do të thotë se çmimet do të vazhdojnë të rriten në javët dhe muajt në vijim më shumë sesa janë rritur për momentin), qeveria shqiptare duhet të kishte ardhur me një buxhet të rishikuar. Qeveria duhet të kishte ardhur këtu me prioritete të ndryshme të vendosura, me një paketë të re rezistence, që të mos na lejonte ne të bënim fjalime populiste këtu, siç tha zoti Braçe, dhe të flisni për ulje taksash, meqenëse dhe FMN-ja paska thënë që nuk është e këshillueshme t'i ulni taksat.

Sigurisht, nuk e këshilloj uljen e përkohshme të taksave, por për taksat të cilat ngrihen në nivelin e pothuajse 3,2 miliardë euro në 8 vjet, që dëmtojnë më shumë punën dhe jo kapitalin (meqenëse e kam thënë në këtë sallë kushedi sa herë: një qeveri që e urren punën, që vetëm takson punën), unë besoj se duhet t'i kishim ndryshuar disa prioritete, si nga politikat fiskale, ashtu edhe nga rishpërndarja e të ardhurave, por edhe nga borxhi publik, duke pasur parasysh njëherë të vetme interesin e qytetarëve. Për ta mbyllur dhe për të mos u zgjatur, sepse besoj se do të ketë edhe kolegë të tjerë që duan të diskutojnë, dëgjova me shumë interes faktin që INSTAT-i paska prodhuar shifra në lidhje me punësimin më të lartë ndonjëherë të shqiptarëve.

Ndërkohë, fatkeqësia më e madhe është që, po të njëjtat institucione, kanë prodhuar shifra për emigracionin më të lartë të shqiptarëve. Sa është forca e punës sot? Sa është forca aktive e punës sot? Si është largimi sot i të rinjve nga Shqipëria? Në qoftë se Shqipëria zbrazet, është e kotë të thoni që është rritur punësimi, sepse me një Shqipëri të zbratur vetëm socialistët do të punësohen, s'ka kush të punësohet tjetër. Shpresoj që Guvernatori, disa nga shqetësimet që unë i ngrita, të cilat i kam diskutuar me të edhe në Komisionin e Ekonomisë, por edhe në platforma tjera, t'i marrë parasysh, jo sepse jam opozitë dhe çdo gjë të bardhë dua ta bëj të

zezë, jo sepse nuk më pëlqen asgjë, por e shoh me shqetësim të ardhmen e financave publike, sepse Edi Rama sot është, por nesër nuk është! Faleminderit!